



YOUTH BANK HUB PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

RAPORT MONITORUES MBI PJESËMARRJEN POLITIKE, SOCIALE, EKONOMIKE TË TË RINJVE NË SHQIPËRI

PËRMBAJTJA RAPORTIT

- 1 Përmbledhje
- 1 Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve
- 2 Krahasim i të Dhënave të Monitoruara përgjatë dy viteve
- 3 Çështje për Advokim dhe Rekomandime

Mungesa e të dhënave zyrtare të përditësuara mbi përfshirjen e të rinjve mbetet ende një çështje për tu adresuar

Përmbledhje

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Partnerët Shqipëri në kuadër të projektit “Youth Bank Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, zbatuar në bashkëpunim me Fondacionin “Ana I Vlade Divac” në Serbi, Shoqatën për Edukim-MLADIINFO International në Maqedoni, Organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe Fondacionin “Community Volunteers” në Turqi, çdo 6 muaj publikon një raport monitorues me qëllim pasqyrimin e situatës dhe analizimin e të dhënave mbi përfshirjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri.

Raporti i gjashtë mujorit të parë, Janar-Qershor 2018, paraqet një përshkrim të shkurtër të të dhënave aktuale mbi gjendjen e pjesëmarrjes politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve, bazuar në matjen e një seti treguesish të mirëpërkufizuar si dhe në të dhënat krahasimore mbi ndryshimet më të rëndësishme të disa prej treguesve përgjatë dy viteve e gjysmë monitorim.

Të dhënat e raportit janë rezultat i kërkimeve nga të dhëna sekondare dhe raporte ekzistuese si dhe informacionin e marrë nëpërmjet kërkesave zyrtare dërguar pranë: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme së Burgjeve, Ministrisë së Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkive të Shqipërisë. Raporti ofron rekomandime dhe iniciativa për advokim në të ardhmen në lidhje me përmirësimin e situatës së përfshirjes politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve.

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

Pjesëmarrja Politike e të Rinjve	Të Dhënat	VITI
Të rinjtë Ministra në Qeveri M/F	0%	2018
Të rinjtë Zëvendës Ministra në Qeveri M/F	3%	2018
Të rinjtë Deputetë në Parlament M/F	4.9%	2018
Të rinjtë Kryetarë të Bashkive	6%	2015-2018
Mjete të komunikimit online për informim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në qeveri dhe parlament	98%	2018
Mjete të komunikimit online për informim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në bashki	67%	2018
Struktura kombëtar të përfaqësimit rinor (këshill/parlament/bord)	0%	2018
Struktura lokale të përfaqësimit rinor (këshill/parlament/bord)	36%	2018

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale Të të Rinjve

“Diplomimi i të rinjve nga institucione të arsimit profesional për vitit akademik 2016-2017 është në masën 87%”

Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve	Të Dhënat	VITI
Të rinjtë në risk varfërie	15%	2012 ¹
Të rinj të varfër	Nuk ka të dhëna	2018
Të rinjtë në burgje	48.3%	2018 ²
Të rinjtë si pjesë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale	Nuk ka të dhëna	2018
Testi PISA - pikë mbi leximin (400/490 mesatarja për OECD)	82.65%	2015 ³
Të rinjtë të larguar nga shkolla e mesme	3.35%	2016-2017 ⁴
Të rinjtë e rregjistruar në universitete	85%	2017-2018
Të rinjtë të diplomuar në universitete	25.19%	2016-2017 ⁵

¹ Publikimi i fundit i përditësuar http://www.instat.gov.al/media/2065/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2012_rishikuar.pdf

² Kërkesë për Informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

³ Publikimi i fundit daton në vitin 2015 <https://www.oecd.org/pisa/pisa-2015-results-in-focus.pdf>

⁴ Të dhënat për vitin akademik 2017-2018 publikohen në shtator 2018, burimi i të dhënave, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

⁵ Përlllogaritur si numri i të diplomuarve në universitete pjesëtar me numrin e personave të rregjistruar në universitete për të njëjti vit akademik, burimi i të dhënave, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve	Të Dhënat	VITI
Norma e të Rinjve jo në Punësim, Arsim apo Trajnim	29.7%	2017 ⁶
Norma e Papunësisë së të Rinjve	25.9%	2017
Norma e Papunësisë Afatgjatë të të Rinjve	13.8%	2017
Norma e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës së të Rinjve	45.8%	2017
Norma e Punësimit të të Rinjve	33.8%	2017
Të rinj që kanë përfituar mbështetje financiare nga shteti për të ngritur një start-up	0.0%	2018 ⁷
Të rinj të vetëpunësuar	28.4%	2018 ⁸

Krahasimi i të Dhënave të Monitoruara përgjatë 2 viteve

Në vitin e tretë radhazi të monitorimit, treguesit mbi gjendjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve kanë pësuar vetëm një përmirësim të lehtë. Në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, në zgjedhjet e fundit parlamentare pati një rritje prej 2.7% të të rinjve deputetë në parlament. Krahasuar me vitin 2015 për herë të parë kemi një përfaqësim prej 3% të të rinjve si Zëvendës Ministra në qeveri. Përdorimi i rrjeteve sociale (website, Facebook dhe Twitter) si mjete për informim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse nga institucionet publike, përgjatë dy viteve e gjysëm periudhe monitorimi është rritur në nivel vendor dhe kombëtar përkatësisht me 15% dhe 3%.

Përsa i përket pjesëmarrjes sociale të të rinjve, përqindja e të rinjve në burgje është rritur nga 36.5% për vitin 2016 në 48.3% në 2018. Për të njëjtën periudhë kohore ka një ulje prej 5.5% të përqindjes së të rinjve të rregjistruar në universitete.

Treguesit e pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve tregojnë një përmirësim të lehtë, krahasuar me të dhënat e dy viteve më parë. Norma e papunësisë tek të rinjtë është ulur në masën 7.3% dhe norma afatgjatë e papunësisë tek të rinjtë është ulur në masën 5.8%. Krahasuar me vitin e shkuar, ka një ulje prej 10% të të rinjve të vetëpunësuar, duke na rikthyer në të njëjtat nivele të vetëpunësimit të të rinjve në periudhën e nisjes së monitorimit.

“Norma e Pjesëmarrjes së të Rinjve në Forcën e Punës përgjatë tri viteve mbetet ende në nivelin e 45.6%”

⁶ Norma e Papunësisë së të Rinjve, Norma e Personave jo në Punësim, Arsim dhe Trajnim, Norma e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës së të Rinjve, Norma e Punësimit të të Rinjve, Instat 2017 <http://www.instat.gov.al/media/3978/njoftim-per-media-tregu-i-punes.pdf>

⁷ Kërkesë për Informacion drejtuar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë

⁸ Kërkesë për Informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Çështje për Advokim dhe Rekomandime

Mungesa e të dhënave statistikore në nivel vendor dhe kombëtar mbi rininë është një prej sfidave të hasura gjatë monitorimit të treguesve mbi përfshirjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri. Mungojnë të dhëna të përditësuara veçanërisht mbi tregues si: përqindja e të rinjve të varfër apo në risk varfërie dhe të rinjtë përfitues nga Skema e Mbrojtjes Sociale.

Pjesëmarrja Politike e të Rinjve

- Edhe pse një nga objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 është krijimi i Bordit Rinor Këshillimor si pjesë e strukturave të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dy vite para përfundimit të periudhës së zbatimit të planit, ende nuk ka asnjë veprim të ndërmarrë në këtë aspekt. Nga ana tjetër edhe pse në nivel vendor janë ngritur disa struktura të përfaqësimit rinor (borde rinore, komisione rinore, zyra) përqindja e bashkive që i kanë ngritur këto struktura është e vogël krahasuar me numrin total të bashkive. Roli dhe funksioni i tyre gjithashtu ndryshon nga një bashki në tjetrën. Krijimi i një modeli standard të strukturave përfaqësuese rinore dhe zbatimi i tij duhet të parashikohet në ligj.
- Partitë politike duhet të përmirësojnë qasjen e tyre për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe demokratike. Duhet të rritet pjesëmarrja e të rinjve në pozicione ekzekutive në nivel lokal dhe qendror. Modelet e sukseshme të Lidërshimit Rinor në politikë si deputetë të rinj, kryetarë bashkie të rinj apo zëvendës ministrat të rinj duhen promovuar më tepër.

Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve

- Arsimi është fusha kryesore që ka nevojë për ndërhyrje, përmes përshtatjes së kurrikulave për arsimin fillor dhe 9-vjeçar, duke përfshirë aktivitete ekstrakurrikulare si klube sportive, arti, ku të rinjtë mund të ndajnë interesat dhe pasionet e përbashkëta dhe mund të angazhohen në jetën sociale, duke i mbajtur të rinjtë larg krimit dhe aktiviteteve të paligjshme. Me qëllim rritjen e

- cilësisë së arsimit dhe njëkohësisht aftësive për jetën, duhet të krijohen klube sociale dhe debati në shkollat e mesme.
- Më shumë fokus duhet t'i kushtohet këshillimit të karrierës, veçanërisht krijimit të qendrave të këshillimit të karrierës në shkollat e mesme duke vënë në dispozicion staf profesional dhe të kualifikuar për të ofruar këshillimin.
 - Duhet të rritet numri i hapësirave publike të dedikuara për aktivitete rinore sportive dhe kulturore.
 - Programet e riintegritimit duhet të përshtaten për të rinjtë në burgje⁹, sipas nevojave dhe situatës së tyre. Këto programe duhet të kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve të të rinjve në aftësitë e ndryshme për jetën dhe trajnimin profesional, duke i përgatitur ata për jetën jashtë burgut.
 - Duhet të krijohen skema mbështetëse të dedikuara për emigrantët e rikthyer, si për shembull duke krijuar mundësi të reja punësimi, ofrimin e granteve për start-upe, trajnime profesionale, njehsimin e çertifikatave të marra nga jashtë, ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët dhe të rinjtë që kanë vështirësi të përshtaten në shkollë etj.

Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve

- Një nga çështjet për advokim është reduktimi i nivelit të lartë të papunësisë, përmes fuqizimit të mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në mundësitë e punësimit, investimin në më shumë mjete online informimi dhe shërbime profesionale që mundësojnë krijimin e aftësive lidhur me punën.
- Krijimi i qendrave të këshillimit të karrierës jo vetëm në universitete, por dhe në shkolla të mesme përbën një prioritet dhe përvoja i përket pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve. Kjo duhet të shoqërohet me më shumë studime për tregun e punës, me qëllim informimin e studentëve për profesionet e ardhshme, duke bërë të mundur përputhjen e pasioneve të tyre me nevojat e tregut.
- Gjatë viteve të fundit, një nga prioritetet e qeverisë ka qënë promovimi dhe orientimi i të rinjve dhe studentëve drejt arsimit profesional. Përditësimi i kurrikulave sipas nevojave të tregut të punës është shumë i rëndësishëm për të siguruar punësimin e të rinjve të diplomuar nga këto institucione arsimore.

⁹ Përqindja e të rinjve në burgje është llogaritur si numri i të rinjve në burg kundrejt numrit total të të burgosurve në Shqipëri

- Duhet të krijohet një mjedis mundësues për zhvillimin e biznesit të vogël, ndërtimin e aftësive sipërmarrëse si dhe lehtësimin e marrjes së kredive. Mungesa e fondeve për start-upe të ofruara nga shteti mbetet një çështje që ofron mundësi të kufizuara për sipërmarrësit e rinj. Nuk duhet thjesht të krijohen më shumë skema mbështetëse për start-upet, por dhe të promovohen më shumë duke targetuar të gjithë të rinjtë sipërmarrës ekzistues dhe potencialë. Edhe pse Minitria e Financave dhe Ekonomisë ofron skema mbështetëse për start-upet për sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm, duhet të ketë më shumë promovim dhe transparencë mbi përfitimin nga këto skema dhe përdorimin e fondeve.